

**Njoftim për përqendrimin me të cilin "Telekom Srbija" shoqëri aksionare, Beograd,
Republika e Serbisë do të fitojë kontroll mbi TTTV ELEKTRO KDS SHPK
BEOGRAD (ÇUKARICA), Beograd, Republika e Serbisë**

(lënda nr. 08-156/2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 18.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin "Telekom Srbija" shoqëri aksionare, Beograd, me seli të regjistruar në rrugën "Takovska" numër 2, Beograd, Republika e Serbisë, synon të fitojë kontroll të drejtpërdrejtë individual mbi TTTV ELEKTRO KDS SHPK BEOGRAD (ÇUKARICA), me seli të regjistruar në rrugën Stevana Dimitrijaviq 9, Beograd, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

"Telekom Srbija" shoqëri aksionare, Beograd, është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, i regjistruar për telekomunikime kabllore dhe kryesisht shërbime të telefonisë fikse dhe mobile, internet dhe shërbime multimediale në territorin e Republikës së Serbisë.

"Telekom Srbija" shoqëri aksionare Beograd ka një subjekt të lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe ai është:

Shoqëria për tregti dhe shërbime MTEL SHPKNJP Shkup, selia e së cilës është e regjistruar në rrugën "Maksim Gorki" 11/1-3, Shkup, Qendër, e regjistruar për veprimtari: telekomunikime me tela, gjegjësisht për ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: rrjet publik radio-komunikues, qasje në internet me brez të gjerë, shërbime ndër-operatorësh, shërbime telefonike publike të disponueshme në rrjetin publik të komunikimeve mobile, ritransmetim të shërbimeve programore televizive, satelit.

Subjekt i lidhur i MTEL SHPKNJP Shkup është Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup operon në tregun për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile (shërbim prepaid) dhe nuk u ofron përdoruesve të saj final shërbim mobil postpaid. Shoqëria për telekomunikime MTELMOBILE SHPKNJP Shkup është operator rrjeti virtual celular (ORRVC) në tregun maqedonas të komunikimeve elektronike dhe ofron shërbime zëri, SMS dhe interneti kombëtar, ndërkombëtare dhe roaming.

Gjithashtu, subjekt i lidhur i "Telekom Srbija" shoqëri aksionare Beograd në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin Partizanski odredi nr. 17, 1-001/Shkup – Qendër, Qendër, e regjistruar për veprimtari të telekomunikimeve satelitore.

TTTV ELEKTRO KDS SHPK BEOGRAD është operator për shërbime dhe rrjete të komunikimeve elektronike, në momentin e parashtrimit të Njoftimit, i regjistruar për ofrimin e qasjes në internet dhe shërbimeve të internetit, distribuim të përmbajtjes mediatike.

TTTV ELEKTRO KDS SHPK BEOGRAD nuk ka subjekte juridike të lidhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe as nuk ka realizuar të ardhura në atë territor.

Sipas parashtruesit të njoftimit, për qëllimet e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, tregjet relevante janë tregu i shitjes me pakicë për ofrimin e shërbimeve të qasjes fikse në internet me brez të gjerë, tregu i shitjes me pakicë për ofrimin e shërbimeve të distribuimit të përmbajtjes mediatike.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre për këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën. Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

05.11.2025

Shkup